

**V E N D I M**  
**Nr. 635, datë 21.11.2001**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 337, DATË 15.7.1999 TË KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE "PËR KRIJIMIN E KOMISIONIT QEVERITAR PËR PROBLEMET UJORE  
ME VENDET FQINJE"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4 të nenit 5 të ligjit nr. 8093, datë 21.3.1996 "Për rezervat ujore", me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Turizmit, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

Në vendimin nr.337, datë 15.7.1999 të Këshillit të Ministrave të bëhen këto ndryshime:

1. Pika 2 të ndryshohet si më poshtë vijon:

"2. Komisioni kryesohet nga Zëvendësministri i Punëve Publike dhe Turizmit dhe ka në përbërje përfaqësues nga:

- Ministria e Punëve të Jashtmeanëtar
- Ministria e Rendit Publik"
- Ministria e Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë"
- Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit"
- Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit"
- Ministria e Mjedisit"
- Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit"
- Ministri i Shtetit për Energjetikën"
- Akademia e Shkencave"
- Sekretariati Teknik i KKU-së"

2. Pika 3 të ndryshohet si më poshtë vijon:

"3. Titullarët e ministrive dhe institucioneve të lartpërmendura të emërojnë përfaqësuesit e tyre brenda një muaji nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.".

3. Pika 7 të ndryshohet si më poshtë vijon:

"7. Shpenzimet për zhvillimin e veprimtarisë së komisionit dhe të nënkomisioneve (pagesat, transporti, dietat, etj.) të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Punëve Publike dhe Turizmit.".

4. Pika 9 të ndryshohet si më poshtë vijon:

"9. Ngarkohet Ministria e Punëve Publike dhe Turizmit për zbatimin e këtij vendimi.".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Ilir Meta**